

## **Fragen und Antworten zur Coronaschutzverordnung ab 25. Januar 2021**

### **Pyetje dhe përgjigje në lidhje me Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi, duke filluar nga data 25 janar 2021**

**Urdhëresa për Mbrojtjen nga Koronavirusi - E vlefshme duke filluar nga data 25 janar**

### **Në datën 19 janar, qeveria federale dhe Landet kanë vendosur për zgjatjen e masave dhe rregullave të tanishme si dhe për vendosjen e disa rregullave të reja. Duke filluar nga cila datë vlejné rregullat e reja në Nordrhein-Westfalen?**

Kryeministrat dhe Kryeministret e Landeve dhe Kancelarja e qeverisë federale kanë vendosur në datën 19 janar për zgjatjen deri në 14 shkurt të masave dhe rregullave të cilat ishin të vlefshme si fillim që nga 11 janari, si dhe për masa të mëtejshme të cilat e luftojnë përhapjen e virusit në mënyrë edhe më efektive. Rregullat e reja në Nordrhein-Westfalen do të hyjnë në fuqi me Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi, e cila vlen duke filluar nga data 25 janar 2021.

Kryeministri Armin Laschet informoi mbi rezultatet pas këshillimeve midis qeverive federale dhe Landeve ([zum Video](#)).

### **Cilat kufizime të kontakteve sociale janë të vlefshme?**

Deri në datën 14 shkurt janë të vlefshme kufizimet e mëtejshme të kontakteve sociale: Takimet në hapësirat publike lejohen vetëm midis pjesëtarëve të një bashkësie familjare si dhe atë të një personi tjetër. Ky person mund të shoqërohet nga fëmijë nga bashkësia e tyre familjare të cilët kanë nevojë për kujdes; në kuadër të ekzistencës së drejtës për vizitë, prindi i ndarë mund të shoqërohet gjithashtu nga fëmija i cili ka nevojë për kujdes.

Përrjashtimet e mëparshme në lidhje me distancën minimale vazhdojnë të vlejné tërësisht të pandryshuara dhe gjenden tek § 2 Paragrafi 2 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi. Këtu përjashtohen ndër të tjera fëmijët të cilët luajnë në një kënd lojërash, frekuentimi i transportit publik me maska mjekësore ose shoqërimi dhe mbikëqyrja e të miturve dhe personave në nevojë kujdesi.

### **A ka ndryshime në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskave?**

Po. Duke filluar nga data 25 Janar 2021 vlen në mjedise të caktuara detyrimi për mbajtjen e maskës mjekësore. Maskat mjekësore në kontekstin e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi janë të ashtuquajturat maska kirurgjikale të standardit EN 14683 (kjo duhet të jetë e cilësuar tek paketimi i produktit) ose maskat e standardeve KN95/N95 ose FFP2.

Detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore ekziston pavarësisht të ruajtjes së distancës minimale:

- në biznese të shitjes me pakicë, farmaci, pika karburanti, banka si dhe tek zyra e mjekut e mjedise të ngjashme mjekësore
- tek transporti publik - gjithashtu tek stacionet e trenit dhe tek ndalesat
- gjatë shërbimeve fetare dhe mbledhjeve të tjera ne lidhje me ushtrimin fetar, edhe në rastet kur personat janë të ulur.

Sipas ligjit federal (SARS-CoV-2-Arbeitsschutzverordnung des Bundesministeriums für Arbeit und Soziales duke filluar nga 20 janar 2021), ekziston gjithashtu detyrimi për të mbajtur një maskë mjekësore tek vendi i punës, aty ku nuk respektohet distanca minimale prej 1.5 metrash. Punëdhënësi duhet të vendosë në dispozicion në këtë rast maskat mjekësore. Detyrimi për mbajtjen e maskës vlen veçanërisht në mjediset e mëtejshme, megjithëse mbajtja e një maske të thjeshtë vazhdon të jetë e mjaftueshme këtu:

- në ndërtesa të mbyllura në hapësira publike, për sa kohë që këto janë të aksesueshme – me ose pa kontroll të hyrjes – nga klientë ose vizitorë,
- në markete dhe pika shitje të ngjashme në mjedise të jashtme
- para dyqaneve të shitjes me pakicë dhe vendeve të parkimit e rrugëve të cilat kanë lidhje me to

## **Pse nuk mjafton më mbajtja e maskës jomjekësore në vende të caktuara?**

Mbajtja e një maske për mbulimin e hundës dhe gojës ka treguar të jetë një masë veçanërisht efektive gjatë pandemisë. Maskat e thjeshta jomjekësore nuk e mbrojnë mbajtësin e maskës aq sa mbrojnë mjedisin e tij. Tani duke pasur parasysh mutacionet veçanërisht infektive të mundshme të virusit, qeveria federale dhe Landet vënë në dukje se maskat mjekësore - të ashtuquajtura maska kirurgjikale ose maska të standardeve KN95/N95 ose FFP2 - kanë një efekt mbrojtës më të madh se maskat e përditshme, të cilat nuk janë të detyruara të përmbushin standarde teknike për efikasitetin e filtrimit. Si rrjedhim, nuk garantohet dot efikasiteti i tyre në lidhje me mbrojtjen e shëndetit.

Në përputhje me vendimin e marrë nga qeveria federale dhe Landet në datën 19 janar 2021, vlen duke filluar nga data 25 janar 2021 detyrimi për të mbajtur maska mjekësore në mjedise ku zhvillohet tregti, tek zyrat e mjekut dhe tek mjediset e transportit publik (duke përfshirë stacionet e trenit dhe ndalesat), gjatë shërbimeve fetare dhe mbledhjeve të tjera ne lidhje me ushtrimin fetar, edhe në rastet kur personat janë të ulur.

## **Çfarë janë “maskat mjekësore” dhe si mund t’i njohim ato?**

Maskat mjekësore përfshijnë maskat kirurgjikale, maskat FFP2/FFP3 (pa valvul) dhe maska të ngjashme, si për shembull maskat për mbrojtjen e rrugëve dhe organeve të frymëmarrjes (Maskat CPA si për shembull KN95/N95). Një maskë kirurgjikale e dallojmë pas një vizite tek mjeku ose spitali. Është e përbërë nga material plastik, është drejtkëndëshe me palosje dhe kryesisht jeshile ose blu. Sipas aprovimit të DIN EN 14683, maska kirurgjikale vlen si maskë mjekësore dhe si rrjedhim lejohet. Një maskë FFP2 (e prodhuar sipas DIN EN 149) përbëhet kryesisht nga pëlhurë e bardhë jo e endur e cila vendoset në një formë sqepi.

Karakteristikat për maskat FFP2 (si dhe maskat e ngjashme CPA) [një broshurë aktuale informacioni e Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.](#)

Duke qenë se konsiderohen produkte mjekësore dhe pajisje mbrojtëse personale, maskat kirurgjikale dhe ato FFP2 i janë nënshtruar një procesi të kërkuar ligjor, para se ato të hidhen në treg në Evropë. Si rrjedhim ato kanë të gjitha të printuara një specifikim të prodhuesit, një etiketim të qartë të modelit si dhe një etiketim CE, nëpërmjet të cilave prodhuesi deklaron përputhjen me këto rregullore evropiane sigurie. Tek maskat kirurgjikale specifikimet gjenden tek paketimi dhe jo tek vetë maska.

## **Cilat rregulla vlejnë për fëmijët në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?**

Për më tepër, fëmijët të cilët janë në moshë më të vogël se moshja e hyrjes në shkollë, janë të përjashtuar nga detyrimi për mbajtjen e maskës. Nëse një maskë nuk i rri si duhet një fëmije nën moshën 14 vjeç, një maskë jomjekësore do të mjaftojë në vendet ku një maskë mjekësore është e detyrueshme.

## **A është e detyruar puna nga shtëpia?**

Ministria Federale e Punës ka lëshuar një Urdhëresë (SARS-CoV-2-Arbeitsschutzverordnung des Bundesministeriums für Arbeit und Soziales vom 20. Januar 2021), e cila i kërkon punëdhënësve t'i lejojnë punonjësit të punojnë nga shtëpia kurdo që të jetë e mundur. Kështu do të reduktohen kontaktet sociale tek vendi i punës dhe gjatë vajtjes për në punë. Urdhëresa do të hyjë në fuqi në kohën e duhur.

## **Si është situata ligjore tek sektorët e gastronomisë dhe të mjediseve ku qëndrohet gjithë natën?**

Restorantet dhe tavernat do të qëndrojnë të mbyllura, kjo vlen gjithashtu për mensat dhe sallat e ngrënies.

Lejohen vetëm shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit ose tavernës. Sallat e ngrënies të kompanive dhe mensat në institucione arsimore mund të përjashtohen nga ky rregull dhe të zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe t'u ofrojnë shërbime punonjësve ose përdoruesve të institucioneve arsimore vetëm nëse proceset e punës ose veprimtaria e lejuar edukative pengohet nga mungesa e këtij shërbimi.

Qëndrimet tërë natën për qëllimet private janë të ndaluara. Tek qëndrimet tërë natën për arsye private nuk përfshihen qëndrimet për arsye biznesi/shërbimi.

## **A janë të mbyllura bizneset e shitjes me pakicë?**

Po. Bizneset e shitjes me pakicë qëndrojnë të mbyllura deri në datën 14 shkurt. Këtu përjashtohen: Dyqanet ku shiten artikuj ushqimorë, shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit ose tavernës, dyqanet ku shiten pije, tregjet javore të produkteve të freskëta, farmacitë, dyqanet të cilat shesin produkte të shëndetshme, dyqanet të cilat shërbejnë për furnizimin me artikuj mjekësorë, dyqanet ku shiten artikuj për bebe, barnatoret, pikat e karburantit, bankat, bankat e kursimit, zyrat postare, kioskat dhe pikat ku shiten gazetatat, dyqanet ku shiten

produkte ushqimore dhe për kujdesin e kafshëve, pikat e shitjes me shumicë (për klientët e pikave të shitjes me shumicë), shpërndarja e ushqimeve nëpërmjet institucioneve sociale (bankave e ushqimit).

## **A është e mundur dërgesa e produkteve tek klientët dhe marrja e produkteve nga vetë klientët?**

Po. Porositja e produkteve dhe dërgesa e tyre në shtëpi është e lejuar. Marrja e produkteve nga klientët lejohet vetëm nëse mund të ndodhë pa kontakt fizik dhe duke respektuar masat për mbrojtjen nga infeksionet.

## **A lejohet hapja e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive?**

Veprimtaria e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive dhe për kopshte lejohet vetëm për të furnizuar personat e vetëpunësuar të cilët kanë një biznes. Personat e tjerë nuk lejohen të hyjnë në këto biznese.

## **Cilat rregulla vlejné në lidhje me shkollat?**

Mësimi në klasa do të pezullohet deri në datën 14 shkurt 2021.

Në të gjitha shkollat dhe llojet e tyre, mësimdhënia do të mundësohet si mësim në distancë për të gjitha klasat duke filluar nga e hëna, 11 janar 2021. Ky rregull vlen gjithashtu dhe për studentët e vitit të fundit.

Tek [Faqja e Ministrisë për Shkollat dhe Arsimit](#) mund të informoheni gjerësisht në lidhje me temën e koronavirusit dhe shkollave.

## **A ka hapësira për kujdesin ndaj fëmijëve në shkolla, në rastet kur prindërit nuk kujdesen dot për fëmijët?**

Po. Të gjithë prindërit janë njoftuar që për sa kohë të jetë e mundur të kujdesen për fëmijët e tyre në shtëpi, në mënyrë që të arrihet reduktimi i kontaktit.

Në të njëjtën kohë duke filluar nga data 11 janar 2021, të gjitha shkollat ofrojnë kujdes për nxënësit nga klasa e parë në klasën e gjashtë, për të cilët nuk kujdesen dot në shtëpi ose të cilëve u rrezikohet mirëqenia.

Për nxënësit dhe nxënëset në nevojë të një kujdesi special arsimor në shkollat për fëmijët me nevoja të veçanta ose në shkollat e mësimin të përbashkët, ku kërkohet kujdes i veçantë, për shembull në pikat e veçanta të kujdesit të zhvillimit mendor, zhvillimit fizik dhe atij motorik, duhet të sigurohet kujdesi tek moshat e mëdha në konsultim me prindërit ose kujdestarët ligjorë.

## **Cilat rregulla vlejné për kujdesin ndaj fëmijëve?**

Për periudhën kohore nga 11.01.2021 deri në 14.02.2021 vlejné këto pika:

Vazhdon të vlejë akoma garancia për kujdesin ndaj fëmijës, por të gjithë prindërit janë të lutur ta sigurojnë vetë kujdesin ndaj fëmijëve, kurdo të jetë e mundur. Nuk ekziston ndalesa për të hyrë në mjediset e përkujdesjes ndaj fëmijës.

Fëmijët, për të cilët është thelbësor frekuentimi i mjediseve të kujdesit ditor për fëmijë, mund të vazhdojnë të marrin kujdesin e duhur. Për shkak të situatës aktuale të pandemisë së Koronavirusit, është e nevojshme të punohet me grupe fikse, në mënyrë që sasia e kujdesit e rënë dakord me kontratë midis familjeve dhe mjediseve përkatëse të kujdesit të reduktohet kryesisht me 10 orë (nga 45 në 35, nga 35 në 25, nga 25 në 15 orë). Në rastin e kujdesit ditor të fëmijëve, vlen i pandryshuar rregulli i mëparshëm.

Kur prindërit të kenë nevojë për ndihmë dhe kujdestar, ata do ta marrin këtë gjë. Kjo vlen shprehimisht për arsye profesionale, familjare dhe për arsye të vetë fëmijës.

Asnjë fëmijë nuk duhet të lëndohet nga ky "Lockdown". Prindërit duhet të kërkojnë kontakt të besuar tek qendra e tyre për kujdesin e fëmijëve ose tek personat të cilët merren me kujdesin ditor të fëmijëve.

## **A vlen oferta për kujdesin e fëmijëve vetëm për prindër në profesione të caktuara?**

Jo. Përkujdesja është kryesisht e mundshme për të gjithë fëmijët, nëse është absolutisht e nevojshme.

## **A do të qëndrojnë të hapura universitetet dhe programet jashtëshkollore të arsimit në sektorin publik?**

Veprimtaria e mësimdhënies dhe testimit në universitete dhe tek shkollat e shëndetësisë lejohet duke iu nënshtruar kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen nga Infeksioni.

Kështu kurset mund të lejohet të zhvillohen me pjesëmarrje fizike vetëm nëse ato nuk zhvillohen dot pa pjesëmarrje fizike ose nëse nuk mund të shtyhen në një datë tjetër pa disavantazhe serioze për studentët.

Provimet me pjesëmarrje fizike dhe masat përgatitëse për to lejohen vetëm nëse nuk caktohet një datë tjetër për arsye të forta ose nëse caktimi në një datë tjetër është i paarsyeshëm për personat të cilët do të testohen.

## **Çfarë do të ndodhë me institucionet kulturore?**

Koncertet dhe shfaqjet në teatro, opera dhe salla koncerti, kinema dhe institucione të tjera kulturore private ose publike ndalohen deri në 14 shkurt 2021. E njëjta gjë vlen dhe për veprimtarinë e muzeve, ekspozitave artistike, galerive, kështjellave, kalave, përmendoreve dhe mjediseve të ngjashme. I lejohet veprimtaria vetëm kinemave nën qiell të hapur ku shihen filma nga makina, për sa kohë që mbahet distanca prej 1.5 metrash midis makinave.

## **Cilat rregulla vlejné për muzikantët profesionistë?**

Lejohet veprimtaria provë, e cila është pjesë e ushtrimit të profesionit. Gjithashtu i lejohet muzikantëve profesionistë, të zhvillojnë koncerte dhe shfaqje pa audiencë me qëllim regjistrimin e tyre ose për t'u transmetuar në radio dhe internet.

## **Cilat rregulla vlejné për sportet amatore dhe të kohës së lirë?**

Ndalohet veprimtaria e sporteve amatore dhe të kohës së lirë në mjediset publike dhe private të sporteve, palestrave, pishinave dhe në mjedise të ngjashme, njëlloj si në pranverë. Kjo vlen gjithashtu dhe për sportet individuale në mjedise sportive / klube sportive, si tenisi dhe golfi. Lejohen vrapimi dhe ecja duke respektuar kufizimin e kontaktit fizik.

## **Cilat rregulla vlejné për mjediset e kohës së lirë dhe të argëtimit?**

Deri në 14 shkurt 2021 ndalohet veprimtaria e

- pishinave për notim e argëtim, salloneve për nxirje artificiale, saunave dhe banjave termale, si dhe gjithashtu veprimtaria e mjediseve të ngjashme,
- kopshteve zoologjike, parqeve të kafshëve, parqeve të kohës së lirë, mjediseve të brendshme të argëtimit dhe mjediseve të ngjashme për shpenzimin e kohës së lirë (brenda dhe jashtë),
- sallave të lojërave, kazinove dhe mjediseve të ngjashme,
- klubeve, diskotekave dhe mjediseve të ngjashme,
- bordellove, mjediseve ku zhvillohet prostitucioni dhe mjediseve të ngjashme,
- ekskursioneve me anije, karroca, trena historikë dhe mjediseve të ngjashme.

Në pikat dhe bizneset e basteve, lejohet vetëm marrja e biletave, basteve, etj. Nuk lejohet qëndrimi i mëtejshëm (për shembull për të parë lojëra dhe evenimente të cilat lidhen me bastet).

## **A lejohen ende evenimentet dhe mbledhjet?**

Evenimentet dhe mbledhjet, të cilat nuk bëjnë pjesë tek rregulloret speciale të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, ndalohen të paktën deri në 14 shkurt 2021.

Lejohen ndër të tjera nën kushte të cilat përcaktohen sipas rastit:

- Mbledhjet sipas ligjit për mbledhjet (për shembull demonstratat)
- Evenimentet të cilat i shërbejnë nevojave thelbësore të popullatës, mirëmbajtjes së sigurisë dhe rendit publik ose evenimentet të cilat sigurojnë mirëqenien e publikut (për shembull mbledhjet partiake për nominimin e kandidatëve elektoralë ose dhurimet e gjakut) të cilat nuk mund të shtyhen për një periudhë pas 14 shkurt 2021 për arsye ligjore ose faktuale
- Mbledhjet e komiteteve ligjore, shoqërive, partive, klubeve, shoqatave të pronarëve të shtëpive, të cilat nuk zhvillohen dot dixhitalisht
- Varrimet

- Ceremonitë civile
- Shërbimet fetare

## **Cilat rregulla vlejnë për shërbimet fetare dhe mbledhje të tjera në lidhje me ushtrimin e besimit fetar?**

Kishat dhe komunitetet fetare e vendosin deri në çfarë pike mund të mblidhen njerëzit fizikisht, duke pasur parasysh situatën lokale të infeksionit dhe informojnë autoritetet përgjegjëse vendore.

Ato sigurojnë mbajtjen e distancës minimale, kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, paraqitjen e kërkesës për regjistrim për ato mbledhje ku pritet një numër i tillë vizitorësh i cili mund ta kalojë kapacitetin, i kërkojnë pjesëmarrësve të mbajnë një maskë edhe kur ulen (të ashtuquajtura maska kirurgjikale ose maskat e standardeve KN95/N95 ose FFP2), regjistrojnë të dhënat e kontaktit të pjesëmarrësve dhe ndalojnë këndimin në kongregacion.

Rregulloret e përgatitura sipas § 1 Paragrafi nr.3 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi nga kishat dhe komunitetet fetare për shërbimet fetare dhe mbledhjet e tjera për ushtrimin e besimit fetar duhet të dorëzohen tek:

- Staatskanzlei e Landit të Nordrhein-Westfalen nga kishat dhe organizatat gjithëpërfshirëse të tjera të komuniteteve fetare. Për këtë qëllim, kishat dhe organizatat gjithëpërfshirëse të tjera të komuniteteve fetare mund të na kontaktojnë këtu me email: [Referat\\_I\\_B3@stk.nrw.de](mailto:Referat_I_B3@stk.nrw.de).
- Komuna përkatëse nga komunitete fetare dhe shoqatat të cilat nuk i përkasin një kishe ose organizate gjithëpërfshirëse.

Komunitetet, të cilat i përkasin një kishe ose një organizate gjithëpërfshirëse, janë të detyruar t'i koordinojnë planet për mbrojtjen nga Koronavirusi me kishën ose organizatën gjithëpërfshirëse përkatëse.

## **A keni pyetje në lidhje me Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi?**

Atëherë na shkruani tek adresa e email [corona@nrw.de](mailto:corona@nrw.de)